LIGJ
Nr.8306, datë 14.3.1998

PËR STRATEGJINË E PRIVATIZIMIT TË SEKTORËVE ME RËNDËSI TË VEÇANTË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji:

"**E drejta e pronësisë**" është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendin, brenda kufijve të caktuar nga ligji.

"**E drejta e përdorimit dhe e zhvillimit**" janë të drejta që rrjedhin nga gëzimi i sendit, me qëllim përdorimi, shfrytëzimi dhe zhvillimi të tij.

"**Aksion i artë**" është një aksion me karakteristika të veçanta që mbahet nga shteti, për një periudhë kohe të caktuar për të ushtruar të drejta ekskluzive për vendimmarrje, për çështje të veçanta vendimtare të shoqërisë, por jo për punën e përditshme të saj.

"**Letra me vlerë për privatizim**" janë lekë të privatizimit, bono të privatizimit dhe letra me vlerë të emetuara nga Banka e Shqipërisë.

"**Investitor strategjik**" është çdo person juridik që zotëron garanci financiare dhe afirmim në veprimtarinë ekonomike në një sektor të caktuar.

Neni 2

Miratohet strategjia e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë e përgatitur nga Këshilli i Ministrave.

Neni 3

Ndërmarrjet shtetërore dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror që veprojnë në sektorët me rëndësi të veçantë të ekonomisë, janë të hapura për privatizim.

Me privatizim kuptohet transferimi tërësisht ose pjesërisht te personi juridik ose fizik i së drejtës së pronësisë, të përdorimit dhe të zhvillimit.

Transferimi i të drejtës së pronësisë do të realizohet nëpërmjet shitjes së aksioneve të shoqërive ose të objekteve të veçanta të nxjerra nga shoqëritë apo ndërmarrjet shtetërore.

Neni 4

Sektorë me rëndësi të veçantë të ekonomisë kuptohen: industria e energjitikës dhe e mineraleve, e naftës dhe e gazit, postat, telekomunikacionet, pyjet dhe ujërat, rrugët automobilistike e hekurudhore, portet detare, aeroportet, transporti ajror e hekurudhor, si dhe sektori i bankave të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror e shoqëritë e sigurimeve me kapital tërësisht shtetëror.

Neni 5

Përcaktimi i formës dhe i strukturës së formulës të privatizimit të shoqërive me kapital shtetëror në sektorët me rëndësi të veçantë bëhet me ligj.

Neni 6

Këshilli i Ministrave, në çdo vendim që do të marrë për privatizimin e ndërmarrjeve dhe shoqërive që veprojnë në sektorët me rëndësi të veçantë, të parashikojë masat e duhura për të përballuar problemet sociale sipas përcaktimeve të bëra në ligjet e privatizimit të sektorëve përkatës.

Neni 7

Privatizimi i këtyre sektorëve do të realizohet me pjesëmarrjen e investitorëve strategjikë, të cilëve u ofrohen jo më pakë se 30 për qind e aksioneve. Kriteret e përcaktimit dhe procedurat e zgjedhjes së investitorëve strategjikë vendosen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 8

Pjesëmarrja me letra me vlerë për privatizim, në privatizimin e ndërmarrjeve dhe shoqërive të sektorëve me rëndësi të veçantë, përcaktohet në formulën e privatizimit, por në çdo rast ajo nuk mund të jetë më e lartë se 20 për qind e kapitalit të kontabilizuar. Mënyra e përfaqësimit të mbajtësve të aksioneve dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 9

Në rastet e privatizimit me transferim të pjesshëm a tërësor të pronës, zbatohet formula e privatizimit. Formula e privatizimit shpreh përqindjen e kapitalit të shoqërisë që do të mbahet nga shteti, nga investitori strategjik apo investitorë të tjerë dhe kufirin e mundshëm të pjesëmarrjes me letra me vlerë për privatizim. Ajo do të caktohet rast pas rasti nga Këshilli i Ministrave. Në çdo rast paketa që do të privatizohet me pjesëmarrjen e investitorit strategjk, do të paguhet me para.

Neni 10

Kur shteti rezervon të drejtën për të vendosur për probleme që lidhen me interesa publikë e strategjikë ose kur kërkohet të ruhet një masë kontrolli, ai mban në pronësi “aksionin e artë” apo një paketë të caktuar aksionesh. Rastet e mbajtjes në pronësi të shtetit “të aksionit të artë” ose të një pakete aksionesh përcaktohen me ligjet e privatizimit për secilin sektor. Të drejtat që rrjedhin nga “aksioni i artë” përcaktohen në kontratën e shitjes.

Neni 11

Për zbatimin e procedurave të privatizimit, që nga momenti i publikimit të vendimit për privatizimin e shoqërisë, do të respektohet një periudhë minimale prej 6 muajsh, gjatë së cilës do të sigurohet transparenca e nevojshme ligjore për të dhënat, procedurat dhe vendimet e marra.

Neni 12

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të përgatitë projektligjet e nevojshme, sipas përcaktimeve dhe afateve kohore të vendosura në strategjinë e privatizimit dhe të miratojë aktet nënligjore të nevojshme për zbatimin e kësaj strategjie.

Neni 13

Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, me cilësinë e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore, të realizojë zbatimin e strategjisë së privatizimit për sektorët e përcaktuar në nenin 4 (me përjashtim të sektorit bankar dhe të sigurimeve), duke respektuar të gjitha procedurat përkatëse në përputhje me kuadrin ligjor të miratuar.

Neni 14

Ngarkohet Ministria e Financave të realizojë zbatimin e strategjisë së privatizimit në sektorin e bankave të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror dhe të shoqërive të sigurimit me kapitalet tërësisht shtetërore, duke respektuar të gjitha procedurat përkatëse në përputhje me kuadrin ligjor të miratuar.

Neni 15

Paragrafi i dytë i nenit 3 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, shfuqizohet.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2028, datë 30.3.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani